



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen *Hashim Thaçi dhe të bashkakuarit*, më 19 qershor, Trupi Gjykes miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Selimit për t'i përjashtuar nga procesi disa prova në lidhje me një dëshmitar. Trupi Gjykes konstatoi se provat përkatëse kishin vlerë provuese të kufizuar dhe kanë efekt dëmtues të konsiderueshëm për të akuzuarin. Gjithashtu, Trupi Gjykes udhëzoi Prokurorinë të mos bënte pyetje në lidhje me këtë provë gjatë dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit dhe të paralajmëronte dëshmitarin të mos fliste për të gjatë dhënies së dëshmisë.

Më 20 qershor, Trupi Gjykes miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të lejuar dy dëshmitarë të japin dëshmi nëpërmjet videolidhjes. Njëri prej dëshmitarëve nuk mund të udhëtojë për shkaqe shëndetësore, ndërsa për dëshmitarin tjetër Prokuroria ngriti shqetësime për shkaqe sigurie. Trupi Gjykes theksoi se palët mund t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve njësoj sikur të ishin në sallë të gjyqit dhe ekipet e Mbrojtjes nuk paraqitën kundërshtime ndaj kërkesës. Trupi Gjykes theksoi gjithashtu se dëshmia nëpërmjet videolidhjes mund të çojë në proces gjyqësor më të shpejtë.

Seancat në këtë çështje gjyqësore rifilluan këtë javë me dëshminë e dëshmitarit të 73-të të Prokurorisë. Sipas përmbledhjes së Prokurorisë, dëshmitari, Kurtesh Fondaj, është ish-ushtarak i UÇK-së i Zonës Operative të Pashtrikut. Z. Fondaj dha dëshmi kryesisht në seancë publike dhe pa masa mbrojtëse.

Të mërkurën paradite, në fillim të seancës, dëshmitari Kurtesh Fondaj kërkoi të kishte përfaqësim ligjor, pas pyetjeve të Trupit Gjykes një ditë më parë. Trupi Gjykes nuk e miratoi kërkesën e dëshmitarit, duke sqaruar se dëshmitarëve u ofrohet avokat vetëm nëse ka shqetësime në lidhje me vetinkriminimin, e që ky rast nuk ishte i tillë. Trupi Gjykes gjithashtu informoi dëshmitarin se sipas Rregullores së DHSK-së, gjykatësit mund t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve në çdo kohë gjatë gjyqimit.

Të mërkurën pasdite dha dëshmi dëshmitari i 74-t i Prokurorisë, që dëshmoi në seancë private. Pas kësaj, seancat përfunduan për këtë javë.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 1 korrik, duke filluar në orën 10:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, më 20 qershor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e z. Januzi për zgjatje të mëtejshme të afatit për dorëzimin e dosjeve gjyqësore paraprake nga ekipet e Mbrojtjes. Gjykatësja vendosi se dosjet gjyqësore paraprake duhet të dorëzohen





vetëm pasi ajo të lëshojë vendimin mbi kërkesën e Prokurorisë për ndryshim të aktakuzës në këtë çështje gjyqësore. Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi që dosjet gjyqësore paraprake të Mbrojtjes të dorëzohen brenda shtatë ditësh nga lëshimi i vendimit mbi kërkesën e Prokurorisë për ndryshim të aktakuzës. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi gjithashtu se data paraprake për t'ia kaluar dosjen gjyqësore trupit gjykues do të caktohet 14 ditë pas vendimit mbi kërkesën e Prokurorisë.

Raporti vjetor i Dhomave të Specializuara të Kosovës për vitin 2023 tani mund të gjendet në faqen e internetit të DHSK-së në tri gjuhët e Gjykatës: [shqipe](#), [serbe](#) dhe [anglishte](#). Në raport jepet informacion i hollësishëm për veprimtarinë e DHSK-së gjatë vitit 2023.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

